

V E N D I M
Nr.93, datë 25.2.1999

**PËR SHITESË MBI PAGË PËR INSPEKTORËT E ZYRËS SË MBROJTJES NGA
RREZATIMET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 8, të ligjit nr.8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Inspektorët e zyrës së mbrojtjes nga rrezatimet të trajtohen me 25 për qind shtesë mbi pagën bazë.

Ky fond të përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë për vitin 1999.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko